



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:120350  
Datë: 07.08.2024  
Numri i dokumentit: 06027968

**Kom.Dh.Shk.II.nr.994/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Koral& Kras Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Tereza”, e përfaqëson me autorizim Shoqëria Avokatëve SCLR Partners, me seli në Prishtinë, kundër debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë, e përfaqëson me autorizim Arianit Koci, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditori të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1095/23 të datës 31.01.2024, me datë 07.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa e kreditorit Koral& Kras Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Tereza”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1095/23 të datës 31.01.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1095/23 të datës 31.01.2024, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha, sa i përket borxhit në shumën prej 927.00 euro, në pikën II, e ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbartimor P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha, sa i përket detyrimi kryesor në shumës prej 17,302.07 euro, së bashku me kamatën ligjore sipas normës vjetore të interesin prej 8%. Ndërsa në pikën III përfundon pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit ndaj debitorit, sipas urdhërit përmbartimor P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha, për shumën prej 927.00 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Koral& Kras Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Tereza”, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1095/23 të datës 31.01.2024, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi e atakuar ose të njëjtin ta rikthej në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar debitorin.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

*Ankesa e kreditorit është pjesërisht e bazuar*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Koral& Kras Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Tereza”, me datën 06.05.2022, ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 18,229.07 €.

Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave Nr. 4018/21 e datës 08.10.2021, Nr. 4928/21 e datës 23.10.2021, Nr.4953/21 e datës 23.10.2021, Nr.4258/21 e datës 23.10.2021 dhe Nr. 247/22 e datës 19.01.2022, duke urdhëruar debitorin t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 18,229.07 €, me kamatë ligjore prej 8% prej ditës kur është bërë kërkesa e arritshme si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore duke përfshirë edhe shpenzimet e në shumë prej 104.00 euro, avokatit sipas rregullores për Tarifën e Avokatëve, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbartimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1095/23 të datës 31.01.2024, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit The North Unicorn L.L.C., me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha, sa i përket borxhit në shumën prej 927.00 euro, në pikën II, e ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbartimor P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha, sa i përket detyrimi kryesor në shumës prej 17,302.07 euro, së bashku me kamatën ligjore sipas normës vjetore të interesin prej 8%. Ndërsa në pikën III përfundon pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit ndaj debitorit, sipas urdhërit

përmbarimor P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha, për shumën prej 927.00 euro.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret, pas ashqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori dhe atë në lartësi prej 927.00 euro, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se Fatura Nr.4258/21 e datës 23.10.2021, pasi që kjo future nuk është pranuar me rregull nga debitori, pra asnjë dëshmi nuk dëshmon se është dorëzuar në mënyrë të rregullt tek debitori, në këtë drejtim, prapësimi i debitorit për këtë pjesë të detyrimit është i bazuar andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi. Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, për shumën në vlerë prej 17,302.07 euro, Faturave Nr.4018/21 e datës 08.10.2021, Nr.4928/21 e datës 23.10.2021, Nr.4953/21 e datës 23.10.2021 dhe Nr. 247/22 e datës 19.01.2022, për faktin se faturat në bazë të se cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sa i përket pikës III gjykata ka vendosur, në bazë të nenin 12 para.2 të Ligjit Nr.05/L-118 dhe Ndryshim Plotësimin Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore ku përcaktohet se : “ *Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethana e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera*”.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të pjesshëm të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar si në pikën I të dispozitivit, ku rezulton se Fatura Nr.4258/21 e datës 23.10.2021, pasi që kjo future nuk është pranuar me rregull nga debitori, pra asnjë dëshmi nuk dëshmon se është dorëzuar në mënyrë të rregullt tek debitori. Gjithashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë dhe saktë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se në pikën, II të dispozitivit duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.248/22, të datës 06.05.2022, për shumën në vlerë prej 17,302.07 euro, Faturave Nr.4018/21 e datës 08.10.2021, Nr.4928/21 e datës 23.10.2021, Nr.4953/21 e datës 23.10.2021 dhe Nr. 247/22 e datës 19.01.2022, për faktin se faturat në bazë të se cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësonë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, për shumën në vlerë prej 17,302.07 euro,

pasi që këto fatura të lartëcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.1 të LPP-së ku përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa para. 3 përcakton se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, pra janë treguar palët, mallrat/ shërbimet që janë objekt i këtyre faturave dhe të gjitha elementet nga këto dispozita të LPP-së. Gjithashtu sipas nenit 37 të LPP-së përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, pra këto dokumente përmbarimore pra faturat janë bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal. Ndërsa në pikën III, me të drejt është mbështetur në nenin 12 para.2 të Ligjit Nr.05/L-118 dhe Ndryshim Plotësimin Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore ku përcaktohet se: *“ Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethana e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokumente i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se disa faturat nuk janë pranuar nga debitorit. Sa i përket faturave tjera që janë të lartëcekura si në pikën II, ato përmbajnë të gjitha tiparet nga dispozitat e LPP-së, ku janë të pa kontestuar edhe nga debitori për detyrimin që rrjedh prej tyre.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me vërtetimin të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.994/24 dt.07.08.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami d.v.**